



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 26 gusht 2014

Numri i lëndës: 2014-20

Mensur Fejza

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 26 gusht 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 20 mars 2014.

II. FAKTET

2. Faktet, siç janë paraqitur nga ankuesi, mund të përmbliidhen si në vijim.
3. Më 12 dhjetor 2013, ankuesi ka marrë një vendim nga Trusti Pensional i Gjermanisë ("*Deutsche Rentenversicherung Bayern Sued*") ku i refuzohet kompensimi i kontributeve të ankuesit në Fondin Pensional të Gjermanisë për periudhën nga data 18 shtator 1995 deri më 30 nëntor 2001.
4. Më 30 janar 2014, Gjykata Sociale e Landshut-it ka hedhur poshtë padinë e ankuesit kundër Trustit Pensional të Gjermanisë si të pabazuar.

III. ANKESAT

5. Ankuesi përgjithësisht iu drejtohet Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe kërkon që kontributet e tij pensionale në Fondin Pensional të Gjermanisë t'i kompensohen.

III. LIGJI

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
9. Paneli vëren se ankesa e ankuesit lidhet me periudhat e sigurimit në Fondin Pensional të Gjermane. Nuk është treguar se EULEX-i ishte i përfshirë në ndonjë cilësi në këtë çështje.

10. Rezulton se kjo ankesë bie jashtë kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe si pasojë jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (shih *Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013, në par. 9 dhe *U. kundër EULEX-it*, 2013-19, 27 nëntor 2013 në par. 14-15).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se ankesa është e pabazuar në bazë të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese